| | |
|---|---|
| Data | |
| Nr. Prot | |

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN**

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK NË LISTËN SHUMEMERORE TË PARAQITUR NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE, PËR CDO ZONË ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

## I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partitë politike ose koalicionet, pasi janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, duhet të paraqesin listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak.

Neni 67, pika 4 parashikon se, *"Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre."*

Neni 67, pika 6 parashikon se, "*Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumemërore duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini".*

Neni 67, pika 7 parashikon se, *"Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumemërore, KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të Kodit Zgjedhor".*

Neni 175 i Kodit Zgjedhor parashikon se, "*Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor passjell refuzimin e listës shumemërore për t'u regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve".*

Në vlerësim të dispozitave të sipërcituara, kuptohet që numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mundet të jetë më i vogël se numri mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Ky është kushti apo kriteri i parë që duhet të plotësohet në rastin e paraqitjes së listës shumeemreore nga subjekti zgjedhor.

Gjithashtu, po në kuptim të dispozitave të mësipërme, (neni 67, pika 6 e Kodit Zgjedhor), lista shumemerore duhet të respektojë kuotën gjinore. Kjo do të thotë që numri i kandidatëve burra dhe gra duhet të jete i barabaratë dhe i njëpasnjëshëm në renditje. Mosrespektimi i këtij kushti ligjor passjell refuzimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak.

Respektimi i barazisë gjinore detyron paraqitjen e një liste shumemerore që mbyllet me një numër rendor çift.

Nga ana tjetër, neni 67, pika 4 përcakton se numri i kandidatëve në listë shumemërore qartazi ka edhe një kufi të sipërm. Sipas kësaj pike, ky numër është shtuar dy më shumë se numri i mandateve në zonën zgjedhore, por në çdo rast duhet të jetë i plotëpjestuar me 3 (tre). Nëse do të respektonim strikt këtë përcaktim, atëhere do të duhej të mos respektonim kuotën gjinore e cila në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore është një rregullim i posaçëm.

Për këtë arsye, për të respektuar parimin e përcaktimit të kufirit të sipërm të listës shumemërore si dhe kushtin e barazisë gjinore konkludohet se, numri i kandidatëve në listën shumemërore të subjektit

zgjedhor nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve të zonës zgjedhore. Kufiri i sipërm i listës së kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak është numri i mandateve të asaj zone zgjedhore, shtuar 1 (një).

Në mbështetje të neneve të sipërcituara, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve aktin për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

| | |
|---|---|
| **Valbona BALLGJINI** | Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit |
| **Majlinda ÇELMETA** | Drejtoria e Administrimit të Zgjedhjeve |
| **Ylli MERKAJ** | Sekretar i Përgjithshëm |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

| Data: 2023 | Nr: | Ora: |
|---|---|---|

**VENDIM**

**PËR**

**CAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE NË LISTAT SHUMEMËRORE TË PARAQITURA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S:**

1. Numri në listë i kandidatëve për anëtarë të këshillit për çdo bashki do të jetë sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Në listën shumemërore, renditja do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

| BASHKIA | NUMRI I KANDIDATEVE PER ÇDO BASHKI |
|---|---|
| Kamez | 42 |
| Kavaje | 32 |
| Rrogozhine | 22 |
| Tirane | 62 |
| Vore | 22 |
| Delvine | 16 |
| Finiq | 22 |
| Himare | 22 |
| Vlore | 52 |
| Konispol | 16 |
| Sarande | 32 |
| Selenice | 22 |
| Kucovë | 22 |
| Polican | 16 |
| Skrapar | 16 |
| BERAT | 32 |
| Dimal | 22 |
| Bulqize | 22 |
| Klos | 22 |
| Diber | 32 |
| Mat | 22 |
| Kruje | 32 |
| Durres | 52 |
| shijak | 22 |
| Belsh | 22 |
| Cerrik | 22 |
| Gramsh | 22 |
| Elbasan | 52 |
| Librazhd | 22 |
| Peqin | 22 |
| Prenjas | 22 |
| Divjake | 32 |
| Lushnje | 42 |
| Mallakaster | 22 |
| Fier | 52 |
| Patos | 22 |
| Rroskovec | 22 |
| Dropull | 22 |
| Kelcyre | 16 |